



АНАЛИЗА НА СОСТОЈБАТА СО **ГОВОР НА ОМРАЗА** ВО РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

СПИ
ПРИЈАВИ И СПРОТИВСТАВИ СЕ! ПРИЈАВИ И С



ANALIZË E GJENDJES PËR GJUHËN E
URREJTJES NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

ANALYSIS OF THE SITUATION WITH HATE
SPEECH IN THE REPUBLIC OF MACEDONIA

 **ХЕЛСИНШКИ**
КОМИТЕТ ЗА ЧОВЕКОВИ
ПРАВА НА РЕПУБЛИКА
МАКЕДОНИЈА

ANALIZË E GJENDJES PËR GJUHËN E URREJTJES NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË



Shkup, gusht, 2015

Analiza e gjendjes, mbrojtjes dhe mundësive për parandalim të gjuhës së urrejtjes në Republikën e Maqedonisë, është aktivitet nga projekti "Platforma në internet për mapim dhe ndjekje të gjuhës së urrejtjes në hapësirën publike dhe në media". Projekti është mbështetur financiarisht nga Fondi Nacional për Demokraci me seli në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Përgjegjësia për të dhënat dhe qëndrimet e dhëna në këtë analizë janë të Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë.

Botues:

Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë
përfaqësuar nga Kryetari Prof. Dr. Gordan Kallajxhiev

Redaktor:

Prof. dr. Lubomir Danaillov-Fërçkovski,
Fakultetit Juridik në Universitetin “Shën. Kirili dhe Metodij” në Shkup,
profesor për drejtësi ndërkombëtare dhe marrëdhënie ndërkombëtare

Uranija Pirovska,
Drejtoare e Përgjithshme e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në RM

Autorë:

mr. Hristina Shulevska, këshilltare juridike
mr. Jasmina Gollubovska, analiste politike
Viki Mlladenova, analiste politike
Sanja Barllakovska, këshilltare juridike



Naum Naumovski Borçe 83
1000, Shkup
Tel: +389 (0)2 3119 073
Faks: +389 (0)2 3290 469
Web: www.mhc.org.mk
E-mail: helkom@mhc.org.mk

PËRMBAJTJA

HYRJA	35
1. E drejta ndërkombëtare dhe standardet për mbrojtje nga gjuha e urrejtjes	37
2. Korniza ligjore dhe mekanizmat për mbrojtje nga gjuha e urrejtjes në Republikën e Maqedonisë	47
3. Shembuj të gjuhës së urrejtjes në Republikën e Maqedonisë	51
PËRFUNDIME	57
REKOMANDIME	58
Literatura e shfrytëzuar	59

Shkurtesa:

- PLP – Prokuroria e Lartë Publike
- KEDNj – Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
- GjEDNj – Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
- BE – Bashkimi Evropian
- PP – Prokuroria Publike
- KEDR – Komiteti për Eliminim të Diskriminimit Racor
- KP – Kodi Penal
- KMD – Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi
- LGBTI – Lesbeje, Gej Burra, Biseksualë, Transeksualë, Njerëz Interseks
- RTM – Radio-Televizioni i Maqedonisë
- MPJ – Ministria e Punëve të Jashtme
- PTHp – Prokuroria Themelore Publike
- OKB – Organizata e Kombeve të Bashkuara
- ShBA – Shtetet e Bashkuara të Amerikës
- KE – Këshilli i Evropës

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë ka zbatuar projektin “Platforma e internetit për mapim dhe ndjekje të gjuhës së urrejtjes në hapësirën publike dhe media”. Një pjesë e aktiviteteve në këtë projekt të cilat duhet t’i zbatojë Komiteti i Helsinkit lidhen me mbikëqyrjen, shënimin dhe informimin për gjuhë të urrejtjes në hapësirën publike dhe në media në kohë reale.

Shënimi i gjuhës së urrejtjes, në nivel qendror dhe lokal nëpërmjet vullnetarëve në platformën www.govornaomraza.mk

Fushatë për promovim të platformës dhe

Analizë dhe rekomandime për parandalim dhe luftë kundër gjuhës së urrejtjes.

Aktiviteti i fundit ose analiza mundëson pasqyrim të gjendjes në Republikën e Maqedonisë dhe qasjen te drejtësia për viktimat e gjuhës së urrejtjes. Për nevojat e kësaj analize është formuar një ekip hulumtues juridik-politik i cili i ka analizuar të dhënat e mbledhura dhe njëkohësisht u ka kushtuar vëmendje legjislacioneve ndërkombëtare dhe legjislacionit nacional si dhe nevojës për konsolidim të tyre në këtë fushë. Në përputhje me metodologjinë, janë përdorur metoda kualitative dhe kuantitative për materialet e mbledhura dhe qasje multidisiplinare me qëllim që t’u jepet përgjigje tezave, pyetjeve të vendosura:

A ka Republika e Maqedonisë një kornizë juridike të qartë dhe të përcaktuar për gjuhën e urrejtjes?

A kanë qasje qytetarët te mekanizmat efikasë dhe efektivë për mbrojtje nga gjuha e urrejtjes?

Teksti i mëtejshëm ka të bëjë me metodat e hulumtimit dhe një përmbajtje e shkurtër e kapitujve që janë punuar në këtë analizë.

METODA KUALITATIVE

Metoda: Hulumtimi juridik

Metoda kualitative e mbledhjes së të dhënave bazohet në mbledhjen dhe analizimin e hulumtimeve juridike, rregullativave ligjore, raporteve ndërkombëtare dhe nacionale nga organizata/institucione ndërkombëtare dhe nacionale. Ekipi i juristëve bëri analizë të të dhënave, përpunoi çështje të hapura dhe mandej i ka dorëzuar tek institucionet kompetente në formë pyetësorësh, në bazë të së drejtës të informacioneve me karakter publik dhe në përputhje me Ligjin për Qasje të Lirë te Informacionet me Karakter Publik. Në lidhje me legjislacionin ndërkombëtar dhe nacional janë përfshirë të gjitha konventat ndërkombëtare, bazat kushtetuese dhe ligjore të cilat e përfshijnë të drejtën e shprehjes së lirë, ndalimin e gjuhës së urrejtjes dhe mosdiskriminimin. Gjatë kësaj janë vërtetuar nevojat për konsolidim të kornizës ligjore ekzistuese me normat dhe standardet ndërkombëtare të cilat lidhen me gjuhën e urrejtjes, sidomos nevoja për përkufizim më të qartë të fenomenit të gjuhës së urrejtjes.

METODA KUANTITATIVE

Metoda: Përpunimi dhe shpërndarja e pyetësorëve

Pyetësorët e përgatitur janë dorëzuar te institucionet kompetente dhe në përputhje me përgjigjet e marra është bërë analiza e të dhënave prej të cilave dolën rekomandimet për përmirësim të kornizës ligjore për mbrojtje nga gjuha e urrejtjes, por edhe për përmirësim të efikasitetit të mbrojtjes së viktimave nga gjuha e urrejtjes. Ekipi hulumtues ka dorëzuar pyetësorë edhe tek institucionet të cilat janë kompetente që t'i mbrojnë viktimat e gjuhës së urrejtjes, por edhe të parandalojnë gjuhën e urrejtjes. Kështu, pyetësorë janë dorëzuar në: Ministrinë e Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm MPB), prokuroritë themelore publike (20 pyetësorë gjithsej) dhe gjykatat themelore në territorin e Republikës së Maqedonisë (24 pyetësorë gjithsej), gjykatat e apelit (4 pyetësorë gjithsej) Gjykatën e Lartë të RM-së dhe Agjencinë për Shërbime Audio dhe Audiovizuale të Mediave. Përveç përgatitjes dhe dorëzimit të pyetësorëve të lartpërmendur, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë gjatë vitit të kaluar ka mbledhur të dhëna edhe nga puna në terren e vullnetarëve e cila është pasqyruar në platformën për shënim të gjuhës së urrejtjes www.govornaomraza.mk dhe paraqitjet individuale të qytetarëve. Në përputhje me të dhënat e mbledhura në 20 qytetet më të mëdha dhe në rajonet përreth janë konstatuar bazat më të shpeshta të gjuhës së urrejtjes, si dhe lidhja e tyre me ngjarjet shoqërore-politike. Mbledhja e të dhënave është bërë në afat prej 16 muajsh, ose nga 1.4.2014 deri më 31.7.2015.

PËRMBAJTJA E KAPITUJVE

Kapitulli 1: Kapitulli i parë u kushton vëmendje legjislacionit ndërkombëtar dhe përkufizimit të termit të gjuhës së urrejtjes nëpërmjet disa shembujve nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Janë përfshirë edhe metodat me të cilat mundësohet perceptimi i dallimit midis gjuhës së urrejtjes dhe shprehjes së lirë nëpërmjet të cilave mund të bëhet më i qartë dallimi, sidomos në procedurat gjyqësore mbi gjuhën e urrejtjes.

Kapitulli 2. Kapitulli i dytë jep një pasqyrim të shkurtër historik të gjuhës së urrejtjes të trajtuar në Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë dhe përfshirjen e përgjithshme të legjislacionit dhe institucionet të cilat duhet të mundësojnë mbrojtje përkatëse të qytetarëve ndaj gjuhës së urrejtjes.

Kapitulli 3. Kapitulli i tretë lidhet me vlerësimin e gjuhës së urrejtjes në Republikën e Maqedonisë dhe funksionalitetin e ligjeve dhe mekanizmave për mbrojtje nga gjuha e urrejtjes. Në këtë kapitull janë analizuar të dhënat e mbledhura prej pyetësorëve të dorëzuar te gjykatat dhe institucionet si dhe nga të dhënat mbi gjuhën e urrejtjes të marra nga platforma. Njëkohësisht, ky kapitull i përpunon edhe përgjigjet e tezave të vendosura dhe përfundimet mbi gjendjen në Republikën e Maqedonisë.

Përfundime dhe rekomandime: Në përputhje me gjendjen e konstatuar, ekipi juridik-politik ka përpunuar përfundime dhe rekomandime për parandalim dhe ballafaqim me gjuhën e urrejtjes në Republikën e Maqedonisë. Rekomandimet lidhen me nevojën për përmirësim të kornizës ligjore nacionale, sanksioneve dhe qasjes te drejtësia nëpërmjet sistemit gjyqësor dhe mekanizmave të pavarur për mbrojtje nga gjuha e urrejtjes.

Analiza, përfundimet dhe rekomandimet do t'u dorëzohen të gjitha institucioneve dhe organeve relevante me qëllim që t'i kushtohet më tepër vëmendje fenomenit si dhe masat parandaluese të mundshme të cilat duhet t'i ndërmarrë shteti me qëllim që të zvogëlohet apo çrrënjohet ky problem shoqëror.

1. E DREJTA NDËRKOMBËTARE DHE STANDARDET PËR MBROJTJE

NGA GJUHA E URREJTJES

Pikëpamjet juridike dhe politike mbi gjuhën e urrejtjes, në përgjithësi, mblidhen gjatë periudhës së luftës ose konkretisht aktivitetet e gjenocidit të Gjermanisë naziste ndaj hebrenjve dhe Holokaustit, përkatësisht përdorimi i kësaj gjuhe në përpjekjen që të dehumanizohet dhe desubjektivizohet grupi konkret i përfaqësuar në shoqërinë gjermane - hebraike.¹ Domethënë, nëpërmjet propagandës dhe mesazheve politike kundër hebrenjve, perspektivat bashkëkohore na çojnë te lidhja midis gjuhës së përdorur me qëllim që të degradohet, diskriminohet dhe përjashtohet grupi konkret dhe strategjitë fizike në realizimin e këtij qëllimi. Në këtë linjë, rreziku nga gjuha e urrejtjes dhe ajo që i paraprin në realizimin e krimeve masive (mass atrocities) është e qartë edhe në rastin e kryerjes së gjenocidit në Ruandë, përkatësisht propagandën² të cilën e përdor Hutu kundër tutsëve (gjatë konfliktit në Ruandë, 1994).

Mekanizmat të cilët janë vendosur në periudhën pas luftime, kurse ishin në drejtim të mbrojtjes dhe garantimit të të drejtave të njeriut iniciuan përpjekje të mëtejshme, në nivel ndërkombëtar, në luftën kundër të gjitha formave të shkeljes së parimeve të dinjitetit dhe barazisë, mostolerancës, antisemitizmit, diskriminimit dhe racizmit. Këto trende të reja në raport me gjuhën e urrejtjes lidhen edhe me transformimin e racizmit në forma të të ashtuquajturit racizmit të ri kulturor që lidhet me shkeljet në bazë të praktikave të ndryshme kulturore të cilat në një farë mënyre vlerësohen si inferiore apo si kërcënim (p.sh.: syneti i grave).

Aleancat e gjera politike të cilat në krijimin e vet kanë vullnetin e mirë për një luftë të tillë, siç është Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe Bashkësia Evropiane (më vonë Bashkimi Evropian/BE) vendosën mekanizma të cilët janë të rëndësishëm në mbrojtjen dhe ndalimin e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut, kurse njëkohësisht janë me rëndësi për temën - gjuha e urrejtjes.

Përkufizimi dhe nevoja e balancimit gjatë vendosjes së ndalimit

Në linjë të dhënies precize të mekanizmave mbrojtës nëpërmjet të drejtës dhe standardeve ndërkombëtare është e nevojshme të përmendet se: 1) nuk ekziston një përkufizim i vetëm dhe përfundimtar për atë se çfarë është gjuha e urrejtjes; dhe 2) gjuha e urrejtjes si institut i veçantë, shpesh, vendoset në një hapësirë vakumi midis të drejtave të ndryshme dhe interpretimit të tyre (për shembull: e drejta e mbrojtjes nga diskriminimi dhe liria e fjalës), kështu që në pjesën e mbrojtjes është sidomos i rëndësishëm roli i gjykatave.

¹ Historia e persekutimit të bashkësive etnike pakicë në Evropë është e gjatë dhe plot me vepra me gjuhë të urrejtjes, por rregullimi i ndalimit daton më vonë, përkatësisht pas Luftës së Dytë Botërore dhe është në proces zhvillimi deri më sot.

² Nga Gjykata Ndërkombëtare Penale e OKB-së për Ruandën janë marrë disa vendime kundër tre punëtorëve në media për fushatë në media, e cila është kryer gjatë konfliktit të viti 1994 në Ruandë. Domethënë, në vitin 1993, radiostacioni "Radio Television Libre des Mille Collines" bëri thirrje për "luftë përfundimtare" për "shfarosje të insekteve (tutsët)", kurse gjatë gjenocidit janë vrarë 800 000 tutsë, nga ky radiostacion janë emituar listat me emrat e njerëzve të cilët duhet të vriten dhe lokacione ku gjenden.

Kështu që në pjesën e parë dhe pasi që nuk ekziston një përkufizim i vetëm dhe përfundimtar se çfarë përfshihet me nocionin gjuha e urrejtjes, nga aspekti i të drejtës dhe standardeve ndërkombëtare mund të merret parasysh përkufizimi i gjuhës së urrejtjes që është dhënë në Rekomandimin 97 (20) për gjuhën e urrejtjes dhe është miratuar nga Komiteti i Ministrave në suazat e Këshillit të Evropës (KE) ku “nocioni ‘gjuha e urrejtjes’ është përkufizuar si” *çdo formë e shprehjes e cila shpërhap, inicion, promovon apo miraton urrejtje racore, ksenofobi, antisemitizëm apo forma të tjera të urrejtjes të bazuara në mostolerancë, duke përfshirë dhe mostolerancën e shprehur nëpërmjet nacionalizmit agresiv dhe etnocentrizmin, diskriminimin dhe armiqësitë ndaj pakicave, emigrantëve dhe njerëzve me prejardhje emigrante*. Me qëllim që të shpjegohet ky nocion mund të zhvendosen edhe disa përkufizime të doktrinuara të gjuhës së urrejtjes si: *“Gjuha e urrejtjes është një lloj gjuhe e cila përdoret që të ofendohet me qëllim individit ose përsëri grupi tjetër racor, etnik, fetar. Ajo mbart mesazh për inferioritet të anëtarëve të grupit të shkelur historikisht dhe gjykon, poshtëron dhe është plot me urrejtje*. (Koen-Almagor, 2006); *“Të gjitha deklinacionet raciste, ksenofobike, homofobike të shprehjes sulmuese të identitetit mund të përmbledhen me nocionin gjuhë e urrejtjes*. (MekGongell)”

Kurse pjesa e dytë dhe nevoja për balancim lidhet me atë që nocioni gjuha e urrejtjes bën ndarje në setin e të drejtave fundamentale, duke i sfiduar së pari individualitetin (nëpërmjet lirisë së shprehjes) dhe barazinë (nëpërmjet të drejtës për mbrojtje nga diskriminimi) si vena të shoqërive liberale. Kjo ndarje apo më saktë nevojë e vendosjes së prioriteteve të vlerave në kontekst, nëpër perspektivën e standardeve ndërkombëtare të vendosura, shihet qartë në qasjen ndaj gjuhës së urrejtjes në vende të ndryshme, përkatësisht tradita të ndryshme juridike (e drejta kontinentale dhe precedente). Është e rëndësishme gjuha e urrejtjes, si institut, duhet të veçohet nga “e folura e zakonshme me urrejtje” në lidhje me disa tema aktuale politike ose cilado tema nga sfera publike, meqenëse trajtimi i veçantë i gjuhës së urrejtjes, në aspektin e mbrojtjes, është i ndryshëm nga trajtimi i llojit tjetër i të shprehurit abraziv dhe ndikimi vijues (siç është shembulli me ofendimin, shpifjen apo diskriminimin indirekt). Domethënë, mekanizmat mbrojtës tek gjuha e urrejtjes janë dizajnuar të mbrojnë një listë precize të karakteristikave fundamentale apo të pandryshueshme të identitetit të çdo individit të cilat e përbëjnë shumështresimin thelbësor të identitetit që nuk mund të ndryshohet edhe përkrah koncepteve “hyrje” dhe “dalje” nga kultura. Pikërisht ajo pjesë e identitetit të individit i krijon lidhjet e detyrueshme (binding ties) me një grup të caktuar i cili ka sistem të përbashkët të vlerave, i cili reflekton njëkohësisht edhe marrëdhënien e ndërtimit të vetë grupit. Vërejtja për dallimin në mbrojtje tek gjuha e urrejtjes, për dallim nga llojet e tjera të të shprehurit abraziv, është e rëndësishme sepse ky institut mbron karakteristika të tjera të individit të cilat mund të jenë pjesë e urrejtjes, kurse njëkohësisht janë të ndryshueshme dhe varen nga rrethanat e ndryshme jetësore të përzgjedhjes së individit. Në këtë kuptim, karakteristikat fundamentale të cilat mbrohen nga gjuha e urrejtjes janë: raca, feja, gjuha, përkatësia etnike dhe prejardhja kombëtare, mangësitë fizike dhe mendore, orientimi seksual dhe/ose identiteti gjinor. Lista e tillë e karakteristikave të mbrojtura fundamentale të individit të cilat mund të shkelen me gjuhën e urrejtjes duhet të jetë e mbyllur me patjetër, dhe asaj nuk duhet t’i shtohen edhe karakteristika të tjera të mundshme të identitetit të cilat janë të ndryshueshme (si afilimi politik, statusi bashkëshortor, niveli i arsimit, pozita sociale). Nevoja e tillë del nga veçantia e gjuhës së urrejtjes në raport me llojet e tjera të të shprehurit abraziv të cilat nuk e shkelin koherencën e identitetit të individit në të njëjtën mënyrë, si edhe nga nevoja që mbrojtja nga gjuha e urrejtjes të jetë normativisht e qartë dhe efektive. Në fund, edhe përkrah përkufizimit të vetëm dhe rreptësisë së kuptimit të këtij instituti, dallimi i qartë prej llojeve të tjera të të shprehurit

abraziv nëpërmjet shkeljes që mund të bëhet, e implikon trajtimin e mbrojtjes së karakteristikave fundamentale të identitetit i cili ka edhe qëllim edhe kuptim vetëm kur lista e tillë e karakteristikave është e mbyllur në mënyrë rigoroze dhe respektivisht e normative.³

Në linjën e veçantisë së lëndimit i cili kryhet me gjuhën e urrejtjes, përsëri, do të theksohet edhe ai raport i mbivlerësimit negativ të dinjitetit të individit, kështu që raporti i tillë pasqyrohet mbi respektin personal dhe vetëperceptimin. Kjo do të thotë se me gjuhën e urrejtjes i imponohet individit pozitë ku ai është inferior dhe më pak i rëndësishëm si qenie njerëzore, dhe kjo në nivel politik, juridik, kulturor, social. Si rrjedhim kur tolerohet kjo gjuhë me vullnet të keq politik, por edhe me legjislacion të defokusuar dhe mandej edhe praktika gjyqësore e tillë, në shoqëri vazhdon “kultura e dhunës” e cila i shpërbën marrëdhëniet shoqërore dhe imponon pozita të fuqisë - të dëmshme për “gërshetimin qytetar”. Në të vërtetë, prania e padënueshme e gjuhës së urrejtjes dhe rreziku i pasqyrimin ndaj dhunës mbi viktimat e mundshme dëshmojnë se karakteristikat fundamentale të individit, si dhe grupit të cilit i përket individit dhe me të cilin i ndan këto karakteristika janë të lëndueshëm dhe kështu gjenerohet një “histori e opresionit” ndaj grupit.

Nga ana tjetër, historia e opresionit të grupit nuk gjenerohet me ndonjë trajtim tjetër të pabarabartë të individit nëpërmjet të shprehurit abraziv dhe veprimeve siç janë ofendimi, shpifja dhe diskriminimi. Gjuha e urrejtjes dhe inkriminimi i kësaj gjuhe abrazive është i ndryshëm nga ofendimi, shpifja dhe diskriminimi pikërisht për faktin se me këto vepra nuk shkelet individit në të njëjtën mënyrë dhe me të njëjtin efekt mbi pozitën e identitetit të tij. Kjo do të thotë se tek ofendimi, shpifja dhe diskriminimi shkelja e individit është më e ndryshme ose ndoshta më e lehtë, prandaj duhet të trajtohet ndryshe aspekti politik dhe juridik.

Kështu, tek ofendimi dhe shpifja, para së gjithash nga aspekti juridik, duhet të përmendet se ata më shpesh kanë trajtim qytetar juridik, kurse gjuha e urrejtjes ka trajtim penal juridik. Pozicionimi i tillë normativ i gjuhës së urrejtjes njëkohësisht nënkupton edhe përgatitje politike të shoqërisë që të gjykojë një raport të tillë ndaj një grupi të caktuar apo individit që i përket atij grupi sipas karakteristikave të tij fundamentale. Pikërisht përjashtimi i tillë i karakteristikave fundamentale, kur bëhet fjalë për shpifjen dhe ofendimin, në rastin kur individit i janë shkelur nderi dhe reputacioni, përkatësisht kur ai është i pasqyruar në një trajtim poshtërues dhe thënien të pavërtetave për të, domethënë se individit është sulmuar i izoluar nga përkatësia e tij në grup dhe lidhja e identitetit. Prandaj, nëse ndodh e njëjta shkelje e nderit dhe reputacionit të individit, me qëllim që të sulmohet lidhja e identitetit me grupin të cilit i përket, kjo është një rrethanë vështirësuese në dënimin e një raporti të tillë, sepse trajtohet si gjuhë e urrejtjes dhe jo si shpifje apo shkelje.

Dallimi i diskriminimit, përsëri, krijon edhe njohje fillestare të gjuhës së urrejtjes, duke pasur parasysh se diskriminimi është i pandarë nga gjuha e urrejtjes. Duke pasur parasysh përkufizimin e diskriminimit si “trajtim i ndryshëm i individit, që përfshin klasifikime të paarsyeshme dhe luftim në një kontekst të dhënë juridik” (Fërçkovski L.D., 2012) mund të konstatohet përfshirja e tillë e diskriminimit gjatë praktikimit të gjuhës së urrejtjes. Kështu, “klasifikimet e paarsyeshme” kryhen nga përkatësia e identitetit të individit, kurse “luftimi në një kontekst të dhënë” imponohet me gjuhën e urrejtjes si pozita inferiore të të njëjtës. Por edhe pse diskriminimi përmbahet në mënyrë të pandashme në

³ Gabimi më i shpeshtë te zgjidhjet euforike për mbrojtjen juridike dhe juristët që i përgatisin ato, është krijimi i listës së karakteristikave të mbrojtura nga gjuha e urrejtjes e cila është e hapur dhe në të cilën vendosen edhe karakteristikat të tjera. Prandaj pasoja juridike është defokusimi i mbrojtjes, përkatësisht humbja e fokusit dhe e kuptimit të të mirës së mbrojtur dhe zvogëlimi i rëndësisë së normës juridike dhe si rrjedhim kjo bëhet joefektive. Pikërisht një gabim të tillë ka në Kodin Penal të Maqedonisë, në pjesët të cilat lidhen me dënimin dhe parandalimin e gjuhës së urrejtjes.

gjuhën e urrejtjes, megjithatë nevojitet paraqitje e qartë e shkeljes e cila konsiderohet si më e rëndë me shfrytëzimin dhe shpërhapjen e gjuhës së urrejtjes, sidomos nëse merret parasysh se lista me karakteristika të individit sipas të cilave mund të diskriminohet ai është e hapur dhe më e gjerë se vetë lista e karakteristikave fundamentale të identitetit, e dhënë më parë.

Organizata e Kombeve të Bashkuara

Me qëllim që të bëhet një pasqyrim i mirë i mekanizmave mbrojtës të cilët nënkuptojnë gjuhën e urrejtjes, përkatësisht zhvillimin e mekanizmave precizë në parandalimin e saj, së pari do të jepen ata të cilët janë vendosur në suazat e OKB-së. Të tilla janë: Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (1948), Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Qytetare dhe Politike (1966) (së bashku me Komitetin për të Drejtat Politike dhe Qytetare që punon në bazë të këtij pakti), Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor e OKB-së (1965) (së bashku me Komitetin për Eliminimin e Diskriminimit Racor i cili punon në bazë të kësaj konvente/KEDR), në vetvete i përmbajnë garancitë dhe mbrojtjen e lirisë së shprehjes (ose më gjerë - liri e fjalës), por njëkohësisht i përmbajnë edhe ndalimet për ato forma të keqpërdorimit të gjuhës dhe shprehjes të cilat janë në drejtim të nxitjes dhe zgjerimit të urrejtjes dhe diskriminimit ndaj grupit të ndryshëm identik, thirrjet për dhunë dhe armiqësi.

Garancitë e tilla të njëkohësishme të lirisë së shprehjes, por edhe ndalime për keqpërdorim të kësaj lirie kur shprehet urrejtje dhe dhunë, që përfaqësohen në mekanizmat e OKB-së, shpjegohen mirë me përfundimin e Komitetit për të Drejtat e Njeriut në lidhje me aktvendimin Forison (Faurisson) vs Franca (Human Rights Committee, Faurisson v. France, Communication No. 550/1993, 8 November 1996). Domethënë, profesori Forison nga Franca ka pasur qëndrime revizioniste në lidhje me Holokaustin dhe strategjitë e gjermanëve në lidhje me shfarosjen e popullatës së hebrenjve, kështu që është gjykuar sipas “Gazssot Act”, sipas të cilit është i dënueshëm mohimi i Holokaustit dhe kontestimi i krimeve të kryera kundër njerëzimit. Komiteti lidhet me aktgjykimin, duke vlerësuar se në këtë rast restriksioni i lirisë së shprehjes arsyetohet nga neni 19 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Qytetare dhe Politike (paragrafi 3,a), dhe se “deklaratat e (autorit) Forisonit, në tërësinë e vet, janë të natyrës së tillë që i përforcojnë ndjenjat antisemitike” dhe si pasojë “ky restriksioni (i lirisë së shprehjes) shërbeu si respekt ndaj bashkësisë hebraike dhe jetës së saj e çliruar nga frika dhe atmosfera e antisemitizmit).”⁴

Me një manovër të ngjashme, edhe Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racor, duke e vlerësuar rastin nëpërmjet spektrit të rëndësisë së nenit 4 të KEDS-së, e dha mendimin e vet në lidhje me rastin Jewish Community of Oslo et al. v Norway⁵, kur gjatë komemoracionit të liderit nazist Rudolf Hes është mbajtur fjalim nga grupi i quajtur “Bootboys”. Komiteti, në lidhje me këtë rast ka vlerësuar se “parimi i lirisë së fjalës mund të lejojë nivel më të ulët në raste të gjuhës raciste dhe gjuhës së urrejtjes” dhe se në rekomandimin e përgjithshëm 15 të Komitetit qëndron qartë ndalimi i të gjitha ideve të bazuara në superioritetin e racës apo urrejtjes dhe i njëjti është kompaktibil me të drejtën e lirisë së shprehjes së mendimit. Komiteti në lidhje me këtë rast vendosi se “idetë e bazuara në superioritetin e racës dhe mbi urrejtjen (..) shprehjet e Hitlerit dhe parimet dhe “hapat” e tij duhet të trajtohen së paku si nxitje e diskriminimit racor, nëse nuk konsiderohen edhe si nxitje të dhunës”, përkatësisht tha se me këtë vendim të Gjykatës së Lartë, Norvegjia e ka shkelur nenin 4 të KEDS-së.⁶

⁴ Ituar Weber Anne, “Manual on hate speech”, Council of Europe, 2009

⁵ Committee on the Elimination of Racial Discrimination, Jewish Community of Oslo et al. v Norway, Communication No. 30/2003, 15 August 2005, para. 10.5

⁶ Cituar Weber Anne, “Manual on hate speech”, Council of Europe, 2009

Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian

Sistemi juridik i BE-së dhe KE-së, për dallim nga ai që përfshihet në funksionimin e OKB-së, është i ngjashëm në raport me gjuhën e urrejtjes, edhe pse në suazat e mekanizmave të BE-së, në aspektin e gjuhës së urrejtjes, jepen më tepër të drejta të cilat janë midis tyre në kolizion kur bëhet fjalë për këtë institut. Domethënë, gjuha e urrejtjes, në këtë rast është në vakum midis kufijve, ndalimit dhe interpretimit të më tepër të drejtave, duke filluar nga konflikti i mëparshëm midis lirisë së fjalës dhe të drejtës për mbrojtje nga diskriminimi, plus edhe e drejta e bindjes fetare, madje edhe e drejta e privatësisë, duke pasur parasysh nga njëra anë strukturën e theksuar multikulturore të BE-së, kurse nga ana tjetër pozicionimin fundamental të gjitha këtyre të drejtave. Si rrjedhim është e rëndësishme të përmendet roli i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) si autoritet i cili mund të kontribuojë në balancimin e këtyre të drejtave, kurse njëkohësisht është në dobi të trajtimit përkatës dënues dhe parandalimit të gjuhës së urrejtjes. Në çdo rast, mekanizmi themelor i cili ka veprim juridik të obligueshëm për shtetet anëtare të BE-së dhe KE-së, nëpër të cilin trajtohet gjuha e urrejtjes dhe implikon zhvillim të mëtejshëm të mekanizmave të cilët do ta përfshijnë më saktësisht këtë institut është Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut e BE-së (KEDNj) (1950) ose më saktë neni 10 i saj. Përveç asaj se me KEDNj-në (neni 10) garantohet e drejta e shprehjes, përkatësisht e mendimit, pranimit dhe marrjes së informacioneve, përmban gjithashtu edhe obligime dhe përgjegjësi apo kufizime gjatë realizimit të kësaj lirie. Nga interpretimi i këtij neni rrjedhin kriteret sipas të cilave GjEDNj-ja mund të përcaktojë se a është i arsyetuar kufizimi i lirisë së shprehjes apo jo, duke pasur parasysh se GjEDNj-ja në punën me rastet të cilat e cekin gjuhën e urrejtjes përdor dy qasje dhe kjo nëpërmjet: 1) nenit 17 me të cilin ndalohet keqpërdorimi i të gjitha të drejtave të garantuara me KEDNj-në dhe 2) nenit 10 paragrafi 2, dhe neni 11 të cilët kanë të bëjnë me lirinë e shprehjes dhe kufizimet:

- parashikimi kufizimeve precize ligjore gjatë lirisë së fjalës, kështu që do të anashkalohet mungesa e bazës juridike për këtë dhe arbitrariteti;

- dhe nëse me ligj parashikohet liria e kufizimit atëherë ajo duhet të ketë qëllime legjitime (të vendosura në paragrafin 2 të nenit 10 të KEDNj-së);

- domosdoshmëria në shoqërinë demokratike del nga proporcionaliteti dhe masa proporcionale e kufizimit të lirisë së shprehjes.⁷

Kriteri i fundit në vendimmarrjen e GjEDNj-së apo masat proporcionale në kufizimin e lirisë së fjalës, në një masë të madhe, lidhen me institutin juridik “margjina e vlerësimit” e cila është e ndryshme në varësi nga rastet (kështu, e njëjta është më e ngushtë në lidhje me rastet e mostolerancë fetare, kurse më e gjerë në raport me mbrojtjen e individëve publikë), kurse parimi i subsidiaritetit u lejon shteteve nëpërmjet legjislacioneve nacionale dhe gjykatave të vendosin se a janë masat kufizuese proporcionale.

Nëpërmjet rastit *Handyside v. the United Kingdom*⁸, GjEDNj i drejtohet pikërisht “margjinës së vlerësimit” duke e theksuar rolin e pushteteve nacionale për përmbushjen primare të “nevojave sociale”, ku shfaqet edhe kriteri i domosdoshmërisë në shoqëritë demokratike gjatë vendimmarrjes së GjEDNj-së. Prandaj, “nuk ka ekzistuar mënyrë tjetër (në këtë rast) që Gjykata ta zërë vendin e vendimmarrjes së gjykatës kompetente nacionale, por ndoshta ta rishqyrtojë vendimin, sipas nenit 10, i cili është dorëzuar me përdorim të fuqisë së tyre të vlerësimit.”⁹

⁷ Më tepër shih te dr. Mihajlova Elena, dr. Baçovska Jasna, mr. Sheqerxhiev Tome “Liria e fjalës dhe gjuha e urrejtjes”, OSBE, Shkup, 2013

⁸ *Handyside v. the United Kingdom*, Application no. 5493/72, Judgment 7 December 1976

⁹ Cituar te Weber Anne, “Manual on hate speech”, Council of Europe, Strasbourg, 2009

Nga ana tjetër, GjEDNj-ja nuk i merr si përfundimtare shpjegimet dhe si rrjedhim dënimin e gjuhës së urrejtjes nga gjykatat nacionale, por GjEDNj-ja ka zhvilluar koncept “autonom”¹⁰ në lidhje me këtë institut, i cili nuk është vendosur në klasifikimet e disa gjykatave nacionale, ose edhe më tepër, disa prej rasteve i klasifikon si gjuhë e urrejtjes dhe kur gjykatat nacionale nuk e bëjnë këtë. I tillë është rasti Syrek v. Turqi (Sürek v. Turkey)¹¹, kur GjEDNj-ja vendosi se ekziston gjuhë e urrejtjes, edhe pse ankuesi nuk është dënuar për përdorim të gjuhës së urrejtjes, por për propagandë separatiste nga gjykatat nacionale, të cilat kanë vendosur se nuk ekzistojnë baza për dënim të ankuesit për nxitje të urrejtjes. Në fund, më shpesh, në aktgjykimet e vete, GjEDNj-ja u referohet të “gjitha formave të shprehjes të cilat nënkuptojnë shpërhapjen, iniciimin, promovimin dhe arsyetimin e urrejtjes së bazuar në mostolerancë (duke e përfshirë edhe mostolerancën fetare).”

Në mënyrë të mirë dhe koherente lidhet edhe me praktikën e Gjykatës së Drejtësisë së BE-së (Gjykata), duke përfshirë të njëjtën mënyrë të diskursit të të drejtave fundamentale të njeriut duke vendosur prioritetet të vlerave në kontekst. Kjo do të thotë se barazimi i praktikave të GjEDNj-së dhe Gjykatës i skicon edhe drejtimit strategjike të zhvillimit të traditave juridike të BE-së në tërësi. Domethënë në shumë raste, Gjykata është ballafaquar me raste të cilat hapin dilema të reja në lidhje me të drejtën e fjalës, por në rastin “Ferin”¹² e ka zhvendosur balancimin e drejtave të cilat janë në konflikt me zgjidhjen konstitutive e cila simbolikisht mund të shënohet si “E drejta evropiane për të drejtën e fjalës.” Domethënë ky rast dëshmon mbi mundësinë se e drejta e fjalës mund të jetë pikëtakimi i garancive kushtetuese në legjislacionet nacionale të vendeve anëtare të BE-së, kornizave tradicionale të legjislacionit evropian, aktgjykimeve të GjEDNj-së dhe Gjykatës, përkatësisht harmonizim i mekanizmave të Brukselit, kështu që përpjekjet në luftën kundër gjuhës së urrejtjes, por njëkohësisht për të drejtën e fjalës mund të fillojnë të njihen si “Amendamenti i parë evropian” (sipas analogjisë së Kushtetutës së ShBA-së).

Edhe përkrah faktit se në rastin “Ferin” ku një prej drejtorëve të firmës “Ferin”, zoti Paskal Ferin në intervistë për gazetën ditore “De Standaard” flet për regrutimin e punëtorëve të cilët montojnë dyer për klientët e tyre trajtohet si rast diskriminimi, gjithashtu, ky rast e ka implikuar edhe raportin e Gjykatës ndaj gjuhës së urrejtjes, sidomos duke marrë parasysh arsyetimin e aktvendimit. Domethënë, deklarata e zotit Ferini se klientët e firmës që e udhëheq ai nuk duan që marokenë t’u futen në shtëpitë e tyre dhe të montojnë dyer, kështu që nuk do të punësojnë marokenë në firmën e tyre ka shkaktuar reagim të organizatës antiracore “Qendra për Mundësi të Barabarta dhe Kundërvënie ndaj Racizmit”, e cila ka kërkuar qasje gjyqësore për zgjidhjen e rastit. Por për të njëjtin, nga Arbeidsrechtbank (gjykatë më e ulët në Strasburg) është vendosur se në deklaratat e zotit Ferini nuk ka diskriminim, por se ato deklarata mund të përdoren si material dëshmues për një diskriminim potencial. Megjithatë me procesimin e mëtejshëm dhe trajtimin e deklaratave të zotit Ferini nga Gjykata, është vendosur se gjuha e urrejtjes në bazë të racës apo gjuhës raciste Gjykata i njeht si forma të diskriminimit, përkatësisht deklaratat me të cilat grupe të caktuara dekurajohen që të aplikojnë për vende pune për shkak të karakteristikave të tyre fundamentale përbën përdorim të gjuhës me të cilën degradohen ato grupe. Në fund, rëndësia e aktvendimit në rastin “Ferin” nga Gjykata qëndron në faktin se ai i ndryshoi drejtimit e Marrëveshjes për Funkcionim të BE-së (neni 19)¹³, si edhe Direktivën 2000/43/KE në Këshillin e BE-së për implementim të parimeve të trajtimit të barabartë të njerëzve pavarësisht nga

¹⁰ Weber Anne, “Manual on hate speech”, Council of Europe, Strasbourg, 2009

¹¹ Sürek v. Turkey [GC], No. 26682/95, ECHR, 1999-IV

¹² Case C-54/07, Centrum voor gelijkheid van kansen en voor racismebestrijding v. Firma Feryn NV, [2008] ECR I, at 5187

¹³ <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:12012E/TXT>

prejardhja e tyre racore dhe etnike.¹⁴ Raporti i tillë i gjykatës kontribuon theksueshëm në përpjekjet antiracore të BE-së, sidomos të pranishme pas Marrëveshjes së Matrihtit (1992), përkatësisht sugjeron vetëdijesimin e institucioneve të BE-së se gjuha bashkëkohore e urrejtjes, në të vërtetë, i pasqyron kompleksitetet dhe ndarjet në “evropianë” dhe “joevropianë”, ndarje të cilat reflektohen dhe nxiten nga ato episode të historisë evropiane me përdorim të gjuhës abrazive kundër hebrenjve dhe romëve dhe pasojat për këto grupe.

Mandej këto ndarje të cilat përmbajnë në vetvete racizëm, (në raport ndaj këtij termi si termin “ombrellë”), kurse nxitin gjuhë të urrejtjes, janë pjesë e praktikës së GjEDNj-së e cila si raste të gjuhës së urrejtjes i përfshin rastet e gjuhës së urrejtjes në bazë të racës, fesë dhe kombësisë, mohimin (krimet masive; Holokausti), fjalimet politike, fjalimet e bazuara në doktrina totalitare.

Por për dallim nga këto baza të cilat lidhen drejtpërdrejt me racizmin, është e rëndësishme të përmendet se GjEDNj-së deri para pak kohe nuk i ka trajtuar orientimin seksual dhe/ose identitetin gjinor dhe aspektin e homofobisë si gjuhë të urrejtjes¹⁵, edhe pse kjo nuk do të thotë se homofobia nuk është njohur si gjuhë e urrejtjes siç është rasti i dokumentit për Dialog Interkulturore i miratuar në sesionin e 118 e Komitetit të Ministrave në vitin 2008. Rasti *Vejdeland dhe të tjerët kundër Suedisë (Vejdeland and Others v. Sweden)*¹⁶ i vitit 2012, ka kontribuar relativisht në deklarimin e qartë të GjEDNj-së në lidhje me faktin se diskriminimi në bazë të orientimit seksual është po aq serioz sa edhe diskriminimi në bazë racore, prejardhjes apo ngjyrës. Domethënë, bëhet fjalë për një rast ku ankuesi është dënua nga gjyqet nacionale për shpërndarje të 100 fletëpalosjeve në shkollat e mesme si veprim i cili është ofendues ndaj homoseksualëve, për shkak të përmbajtjeve të fletëpalosjeve ku është shkruar se “homoseksualiteti ka efekte morale destruktive mbi thelbin e shoqërisë”, se është “afeksion seksual devijues” dhe se është fajtor për zhvillimin e HIV/SIDA. Në lidhje me këtë rast, GjEDNj-ja vendosi se nuk ka ekzistuar shkelje e të drejtës së fjalës (neni 10 i KEDNj-së) nga Suedia, përkatësisht se e drejta e lirisë së fjalës së ankuesit, në mënyrë të arsyetuar i është kufizuar nga pushteti suedez si domosdoshmëri në shoqëritë demokratike për mbrojtjen e reputacionit dhe të drejtat e të tjerëve.

Nga mekanizmat e tjerë të cilët janë të rëndësishëm për sistemin juridik të BE-së dhe KE-së, kurse janë në fushën e dënimit dhe parandalimit të gjuhës së urrejtjes, të rëndësishëm janë Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Mostolerancës (1993), i cili gjatë mbikëqyrjes e ka qasjen “shtet për shtet” dhe kjo kontribuon theksueshëm në prezantimin e gjendjeve konkrete dhe rekomandimet për përmirësim, Qendra Evropiane Monitoruese për Racizëm dhe Ksenofobi (1997), mandej e trashëguar nga Agjencia për të Drejtat Themelore (2007), Karta Evropiane për të Drejtat e Njeriut (2000), Vendimi Kornizë për Veprat Penale Raciste dhe Ksenofobike (2008). Nga legjislativi i BE-së dhe KE-së, është e rëndësishme të përfshihen këto dokumente: Rekomandimi (97)20 mbi Gjuhën e Urrejtjes i miratuar nga Komiteti i Ministrave (1997), Rekomandimi (97)21 mbi Mediat dhe Promovimin e Kulturës së Tolerancës (1997), Deklarata e Komitetit të Ministrave mbi Lirinë për Debat Politik në Media (2004), Rezolutën 1510(2006) për Lirinë e Fjalës dhe Respektin ndaj Besimeve Fetare të miratuar nga Kuvendi Parlamentar, Rekomandimi 1805(2007) për Blasfemi, Ofendime Fetare dhe Gjuhë të Urrejtjes ndaj Personave në bazë të Përkatësisë së Tyre Fetare (2007), Rekomandimi i Përgjithshëm 7 për legjislativin nacional në luftë kundër racizmit dhe diskriminimit të EKRI-së (2002).

¹⁴ <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:32000L0043:en:HTML>

¹⁵ Shënuar “Homophobia and Discrimination on Grounds of Sexual Orientation in the EU Member States Part I – Legal Analysis” (European Union Agency for Fundamental Rights), June 2008

¹⁶ *Vejdeland and Others v. Sweden*, Application no. 1813/07

Qasje e ndryshme ndaj gjuhës së urrejtjes

Duke u udhëhequr nga mekanizmat ndërkombëtarë, legjislacionet nacionale e zgjidhin me lehtësi normimin e dënimit dhe parandalimit të mëtejshëm të gjuhës së urrejtjes, duke i pasur parasysh standardet ndërkombëtare të vendosura më parë në trajtimin e këtij institucioni, të cilat mandej në mënyra të ndryshme janë shndërruar në ligje dënuese, zgjidhje ligjore për ndalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, zgjidhje ligjore për ndalim dhe shkelje të barazisë, zgjidhje ligjore për ndalim të shpërhapjes së mostolerancës fetare, racore, etike dhe nacionale dhe armiqësisë, ose përfundimisht, si zgjidhje të veçanta dhe të specifikuar mbi gjuhën e urrejtjes (duke përfshirë edhe gjuhën në hapësirën sajber). Megjithatë, në varësi nga legjislacioni, por sidomos edhe nga gjyqësori në vende të ndryshme, ato kanë zhvilluar edhe qasje të ndryshme ndaj gjuhës së urrejtjes, përkatësisht u përkasin sistemeve të ndryshme juridike apo evropiane të bazuara në drejtësinë kontinentale dhe amerikane të bazuara në drejtësinë precedente. Kështu, ndarja themelore e vendeve, e realizuar nëpërmjet qasjeve të ndryshme ndaj këtij instituti është pozicionimi juridik, gjyqësor dhe politik i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) përkundrejt shteteve të tjera. Domethënë kjo ndarje bazohet në raportin amerikan ndaj lirisë së fjalës, së garantuar me interpretimin e Amendamentit të Parë të Kushtetutës së ShBA-së i cili “siguron se Kongresi nuk do të miratojë ligj i cili e shkurton lirinë e fjalës... si e drejtë individuale, e cila ngjashëm me të drejtën e pronësisë, nuk mund të shkelet, vetëm nëse nuk lidhet ngushtë me aktivitetin kriminal”.¹⁷ Kështu që pacenueshmëria e lirisë së fjalës e garantuar me Kushtetutë në ShBA, në të njëjtën kohë do të thotë dhe kufizim i vështirësuar i kësaj lirie të qytetarëve amerikanë, përkatësisht kufizimet e tilla janë reduktuar vetëm në doktrinën “rrezik i qartë dhe i pranishëm”.¹⁸ Si shtesë në linjën e mbrojtjes së lirisë së fjalës dhe duke mos vendosur kufizime të qarta, në ShBA lejohet edhe “përfaqësimi i pastër” i veprimeve të paligjshme siç është përfaqësimi i racizmit, me të Drejtën e Branderburgut¹⁹, kurse kjo mund të shihet qartë dhe pa dyshime në rastin *National Socialist Party of America v. Village Of Skokie* (1977).²⁰ Domethënë nga neonazistët është propozuar të mbahet marshimi i tyre me uniformë të tërësishme të SS, me svastika, nëpër Skoki (periferi e Çikagos), ku pjesa më e madhe e popullatës është me prejardhje hebraike, si dhe shumë hebrenj të cilët e kanë mbijetuar Holokaustin. Edhe pse pushteti lokal i mori masat kundër mbajtjes së marshimit, përsëri nga shteti dhe instancat gjyqësore janë anuluar masat të cilat sipas vlerësimit të tyre e shkelnin lirinë e fjalës të neonazistëve. Kështu, përveç mesazhit të qartë të neonazistëve dhe lokacionit të qëllimshëm Skoki për marshimin e tyre, përkatësisht përkrah theksimit nga hebrenjtë se pasqyrimi i svastikës (shënim vendosja e simboleve mund të vlerësohet si gjuhë e urrejtjes) mund të nxitë dhunë, gjykata më e ulët vendosi që marshimi i tillë duhet ndaluar, por Gjykata e Lartë e ndryshoi vendimin, sepse gjykata e ulët ka gabuar me vendimin se marshimi i propozuar i plotëson kriteret e “nxitjes së dhunës” duke mos shpjeguar se çfarë mund ta kënaqë këtë standard.²¹

Por është interesante të përmendim se, edhe përkrah faktit që u përkasin sistemeve të njëjta juridike që bazohen në të drejtën precedente, në Kanada për dallim nga ShBA-ja, si shtet i cili gjithashtu e ka të theksuar strukturën multikulturore, por edhe historinë e racizmit, ekzistojnë kufizime të lirisë së fjalës me qëllim që të balancohet mbrojtja e të drejtave të njeriut. Një rast i cili flet për këtë është *Malkolm Ros v. Kanada* (*Malcolm Ross v. Canada*)²², ku një arsimtar është pushua nga vendi i punës

¹⁷ Mihajllova Elena, “Govorot na omraza i kulturnite razliki”, *Templlum, Shkup*, 2010, f. 64

¹⁸ Shih më tepër te Mihajllova “Govorot na omraza i kulturnite razliki”, *Templlum, Shkup*, 2010, f. 65

¹⁹ Nxjerrë nga rasti *Branderburg v. Ohio*, 395.U.S. 1969

²⁰ *National Socialist Party of America v. Village Of Skokie*, 432 U.S. 43, 1977

²¹ Shih më tepër te Mihajllova “Govorot na omraza i kulturnite razliki”, *Templlum, Shkup*, 2010, f. 68-69

²² Human Rights Committee, *Malcolm Ross v. Canada*, Communication No. 736/1997, 18 October 2000, para.

për shkak të deklaratave diskriminuese ndaj hebrenjve dhe judaizmit. Vendimi i gjykatave kanadeze për kufizim të të drejtës së fjalës në këtë rast ishte e njëjtë me mendimin e Komitetit për të Drejtat e Njeriut se “kufizime mund të lejohen në lidhje me deklaratat të cilat nxisin dhe përforcojnë ndjenjat antisemitike, me qëllim që të mbrohet bashkësia hebraike”²³, kurse nëpërmjet kësaj edhe e drejta e mbrojtjes nga urrejtja fetare, kështu që nga Komiteti është marrë parasysh qartë qëllimi i arsimitarit dhe pozita e tij sociale.

Përkundrejt këtyre shteteve sistemet e të cilave bazohen tek e drejta precedente, shtetet evropiane sistemet juridike të të cilave bazohen në të drejtën kontinentale kanë qasje më të ndryshme ndaj gjuhës së urrejtjes, përkatësisht këmbëngulin për balancim të të drejtave konfliktuese dhe mundësojnë kufizim të lirisë së fjalës, kur kjo, njëkohësisht, nënkupton shkelje të dinjitetit dhe të drejtave të të tjerëve. Në këtë drejtim, edhe përpjekjet për ruajtjen e traditës demokratike, por edhe raporti restriktiv konsistent ndaj aktiviteteve të ndryshme diskriminuese dhe përjashtuese, mund të jepet legjislacioni gjerman dhe praktika gjyqësore me gjuhën e urrejtjes. Domethënë, pozitat progresive të këtij shteti, me qëllim që të pajtohet me të kaluarën e opresionit dhe krimet masovike të kryera gjatë Luftës së Dytë Botërore (Holokaustin), shihen qartë në trajtimin e gjuhës së urrejtjes, si një ndër zgjidhjet ligjore, ashtu edhe vendimet e gjykatave. Një prej rasteve i cili është referent për këtë temë është rasti “Lut”²⁴ i vitit 1958, kur në hapjen e Javës së Filmit Gjerman, presidenti i Hamburg Pres Klab (Hamburg Press Club) zoti Lut bënte agjitacion që të bojkotohej regjisori Vajt Harllan (i famshëm gjatë periudhës naziste), më vonë në gazeta duke theksuar se “kthimi i Harllanit vetëm mund t’i hapë plagët të cilat mezi janë shëruar dhe ta ringjallë mosbesimin fatal për rikonstrukcion të Gjermanisë”, përkatësisht se “nuk është vetëm e drejtë, por edhe obligim i të gjithë gjermanëve të ndershëm të protestojnë kundër, madje edhe ta bojkotojnë këtë përfaqësues të turpshëm të industrisë gjermane të filmit”, dhe për këtë gjykata në Hamburg e ndaloi të vazhdojë me agjitacionin, por ankesa e dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese nga Lut është vlerësuar dhe e ka anuluar ndalimin e Gjykatës së Hamburgut.²⁵

Prej vendimeve të tjera ligjvënëse për ndalimin dhe dënimin e gjuhës së urrejtjes, të përfshira me legjislacionin e vendeve anëtare të BE-së, si shembuj mund të jepen edhe ato të Danimarkës, Francës, Holandës dhe Britanisë së Madhe. Kështu, në Danimarkë, kjo është zgjidhur me nenin 266 (b) të Kodit Penal me të cilin parashikohet kriminalizim i “shprehjes dhe shpërhapjes së urrejtjes racore”; në Francë përsëri, kjo është zgjidhur me një pjesë të Ligjit për Mediat (1881) me të cilin kriminalizohet nxitja e diskriminimit racor, urrejtja dhe dhuna në bazë të përkatësisë apo mospërkatësisë në një grup etnik, nacional, racor apo fetar, kurse me Kodin Penal kriminalizohen veprimet e ngjashme në komunikimin privat; në Holandë si shteti bastion i lirisë së fjalës, kjo është zgjidhur me nenet 137 (c) dhe 137 (d) të Kodit Penal, me të cilat ndalohen ofendimet publike dhe të qëllimshme, si dhe hyrja në nxitje verbale, të shkruar dhe të ilustruar të urrejtjes në bazë të racës, fesë, orientimit seksual apo bindjeve personale; dhe në Britaninë e Madhe kjo është zgjidhur me Aktin për Rendin Publik (1986) ku në kapitullin 18(1) thuhet se “personi i cili përdor fjalë kërcënuese, keqtrajtuese apo ofenduese ose sillet në mënyrë të tillë, përkatësisht shpërndan materiale të shkruara të cilat janë kërcënuese, keqtrajtuese apo ofenduese do të jetë fajtor për ofendim nëse: a) ka qëllim të nxitë urrejtje racore ose b) i ka parasysh të gjitha rrethana të cilat mund të nxitin urrejtje racore”, si edhe në Kapitullin

²² Human Rights Committee, *Malcolm Ross v. Canada*, Communication No. 736/1997, 18 October 2000, para. 11.5.

²³ Cituar te Weber Anne, “Manual on hate speech”, Council of Europe, Strasbourg, 2009

²⁴ BvefGE 7, 198, 1958

²⁵ Cituar te Mihajllova “Govorot na omraza i kulturnite razliki”, Templlum, Shkup, 2010, f. 74

5 të të njëjtit Akt për Rend Publik ku thuhet se është e dënueshme zgjerimi dhe përdorimi i fjalëve kërcënuese, keqtrajtuese apo ofenduese “në vende ku mund të dëgjohen nga një person i cili mund të shqetësohet prej tyre.”

Tregues për identifikim

Nëpërmjet ndjekjes të mekanizmave të të drejtës ndërkombëtare në lidhje me gjuhën e urrejtjes, si edhe standardet e vendosura në dënimin dhe parandalimin e këtij lloji të gjuhës abrazive, mund të vërehet vështirësia themelore e cila del nga nevoja për balancim midis të drejtave të ndryshme fundamentale të cilat ballafaqohen. Domethënë, si mund të vlerësohen si gjuhë e urrejtjes nëpërmjet përpjekjeve të legjislacioneve nacionale për urdhra më të sakta të kufizimeve të lirisë së fjalës nga njëra anë, kurse nga ana tjetër bazat dhe rrethanat sipas të cilave aktivitete të caktuara të shprehjes, ashtu edhe nëpërmjet praktikës gjyqësore dhe përfundimeve në lidhje me garantimin e disa të drejtave mund të vështrohen sfidat rreth identifikimit të gjuhës së urrejtjes. Domethënë, përdoren disa tregues gjatë identifikimit të gjuhës së urrejtjes, duke marrë parasysh se shtetet kanë qasje të ndryshme dhe palët në këtë raport (gjykatësit, prokurorët, mediat, gazetarët, organizatat qytetare) përdorin tregues të ndryshëm në rastet konkrete:

- qëllimi,
- përmbajtja/konteksti
- pasojat/rezultatet e ndaluara.²⁶

²⁶ Më tepër shih te dr. Mihajlova Elena, dr. Baçovska Jasna, mr. Sheqerxhiev Tome “Liria e fjalës dhe gjuha e urrejtjes”, OSBE, Shkup, 2013, f. 33-34

2. KORNIZA LIGJORE DHE MEKANIZMAT PËR MBROJTJE NGA GJUHA E URREJTJES

NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Disa prej vlerave themelore të rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë janë liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe qytetarit të njohura me të drejtën ndërkombëtare dhe të përcaktuara me Kushtetutën. Në përputhje me Kushtetutën, qytetarët e Republikës së Maqedonisë janë të barabartë në liritë dhe të drejtat pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, prejardhja nacionale dhe sociale, bindja politike dhe fetare; gjendja shoqërore dhe e pronësisë. Garantohej liria e fesë, si dhe e drejta e përfaqësuesve të nacionaliteteve që të shprehen lirshëm, të kujdesen dhe ta zhvillojnë identitetin e vet dhe karakteristikat nacionale. Republika u garanton nacionaliteteve mbrojtjen e identitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar. Kushtetuta i mbron të drejtat dhe liritë e njeriut dhe qytetarit që lidhen me lirinë e bindjes, vetëdijes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimit, shoqërimin politik dhe veprim dhe ndalim i diskriminimit të qytetarëve të bazë të gjinisë, racës, përkatësisë fetare, nacionale, sociale dhe politike.

Në Republikën e Maqedonisë nuk ekziston ndonjë ligj i veçantë me të cilin përfshihet dhe përfshihet në mënyrë të detajuar materiali për gjuhën e urrejtjes, i maçishe që do t'i përpunonte theksueshëm përkufizimin, mbrojtjen dhe mënyrat e parandalimit të gjuhës së urrejtjes. Ky fenomen, për herë të parë është inkriminuar me miratimin e Kodit Penal të vitit 1996. Megjithatë, në këtë Kod Penal nuk ka nen koherent dhe konsistent, me listë të mbyllur të karakteristikave, i cili e përfshin në mënyrë të detajuar gjuhën e urrejtjes. Në përputhje me Kodin Penal²⁷, elementë të gjuhës së urrejtjes mund të gjenden në nenin 179 i cili thotë: ai që ka qëllim të tallit publikisht, do ta ketë objekt talljeje popullin maqedonas dhe përfaqësuesit e bashkësive etnike të cilat jetojnë në Republikën e Maqedonisë, do të dënohet me gjobë në të holla dhe neni 319 i cili thotë “ai që me forcë, maltretim, rrezikim të sigurisë, që i përqesh simbolet nacionale, etnike apo fetare, që me dëmtim të objekteve të huaja, me shkatërrimin e përmendoreve, varreve apo në mënyrë tjetër do të shkaktojë ose do të nderë urrejtjen nacionale, racore apo fetare, ndarje apo intolerancë, do të dënohet me burg nga një deri në pesë vjet”. Paragrafi 2 i nenit 319 përcakton se ai që veprën e paragrafit 1 e kryen duke keqpërdorur pozitën apo autorizimin ose nëse për shkak të këtyre vepra kanë ndodhur trazira dhe dhunë kundër njerëzve apo ka ndodhur dëm i pronës në përmasa të mëdha do të dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Gjuha e urrejtjes është inkriminuar nën kushte specifike në nenin 417, paragrafi 3, në përputhje me të cilin, ai që shpërhap ide për superioritet të një race mbi tjetrën apo propagandon urrejtje racore apo nxit diskriminim racor, do të dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet. Një dispozitë e cila e inkriminon gjuhën e urrejtjes nëpërmjet sistemit kompjuterik gjendet në nenin 394-g, përkatësisht, ai i cili nëpërmjet sistemit kompjuterik shpërhap në opinion material racist dhe

²⁷ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 37/1996; 80/1999; 4/2002; 43/2003; 19/2004; 81/2005; 60/2006; 73/2006; 7/2008; 139/2008; 114/2009; 51/2011; 135/2011; 185/2011; 142/2012; 166/2012; 55/2013; 82/2013; 14/2014; 27/2014; 28/2014; 41/2014; 41/2014; 115/2014; 132/2014; 160/2014

ksenofobik të shkruar, fotografi apo prezantime të tjera të idesë apo teorisë e cila ndihmon, promovon apo nxit urrejtje, diskriminim apo dhunë, kundër cilitdo personi apo grupi, në bazë të racës, ngjyrës së lëkurës, prejardhjes nacionale apo etnike, si dhe besimit fetar, do të dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. Nëse ai që e kryen veprën, duke keqpërdorur pozitën apo autorizimin ose nëse për shkak të këtyre vepra kanë ndodhur trazira dhe dhunë kundër njerëzve apo ka ndodhur dëm i pronës në përmasa të mëdha do të dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet

Gjuhë urrejtjeje është dhe çdo miratim apo arsyetim i gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit apo krimeve të luftës. Domethënë, neni 407-a i Kodit Penal i cili thotë: ai që nëpërmjet sistemit informativ i mohon, minimizon, miraton dhe arsyeton publikisht gjenocidin, krimet kundër njerëzimit apo krimet e luftës me qëllim që të nxitë urrejtjen, diskriminimin apo dhunën kundër cilitdo personi apo grupi personash për shkak të përkatësisë së tyre nacionale, etnike apo racore, ose përcaktimit fetar do të dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. Nëse mohimi, minimizimi, miratimi apo arsyetimi kryhet me qëllim që të nxitë urrejtje, diskriminim apo dhunë kundër cilitdo personi apo grupi personash për shkak të përkatësisë së tyre nacionale, etnike apo racore, ose përcaktimit fetar do të dënohet me burgim prej minimum katër vjetësh.

Vepra penale e gjuhës së urrejtjes mund të paraqitet në Ministrinë e Punëve të Brendshme ose mund të dorëzohet fletëparaqitje penale në prokuroritë kompetente publike themelore. Gjuha e urrejtjes në rrjetet sociale mund të paraqitet në Njësinë për Krim Elektronik në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Në përputhje me Ligjin për Ndalim të Dhunës dhe Sjelljes Jodinjitoze në Garat Sportive²⁸, gjuha e urrejtjes në garat sportive mund të paraqitet te nëpunësit policorë të pranishëm në garë apo në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Në përputhje me Ligjin për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi²⁹ si diskriminim konsiderohet çdo sjellje aktive apo pasive e çdo personi nga pushteti publik, si dhe nga personat fizikë dhe juridikë të sektorit privat dhe publik në jetën publike, e cila krijon bazë për privilegj apo mosprivilegj të ndonjë personi në mënyrë të paarsyetuar, ose e pasqyron në raport të padrejtë dhe degradues në krahasim me personat e tjerë në situatë të ngjashme, në bazë të cilësdo bazë diskriminuese (neni 5 paragrafi 4). Në përputhje me nenin 7 të Ligjit, shqetësimi dhe veprimi ofendues janë shkelje e dinjitetit të personit apo grupit të personave që rrjedh nga baza diskriminuese dhe që rezulton me shkelje të dinjitetit të një personi të caktuar apo krijimin e mjedisit, qasjes apo praktikës kërcënuese, armiqësore, ofenduese apo të frikshme. Në përputhje me nenin 9 si diskriminim do të konsiderohet çdo aktivitet me të cilin ndonjë person në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte bën thirrje, nxit, jep udhëzime apo nxit një person tjetër të kryejë diskriminim. Në cilindo prej rasteve të sipërpërmendura mund të dorëzohet ankesë për mbrojtje nga diskriminimi/shqetësimi te Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi. Ankesa dorëzohet në afat prej 3 muajsh nga dita kur është kryer shkelja apo maksimum deri në një vit nga marrja e njohurisë për aktin e diskriminimit.

Në rastet e gjuhës së urrejtjes në radio dhe në televizion, në përputhje me Ligjin për Mediat³⁰ (neni 4), ndalohet që me shpalljen, përkatësisht emetimin e përmbajtjeve në media të rrezikohet siguria nacionale, të nxitet rrëzimi me forcë i rendit kushtetues i Republikës së Maqedonisë, të bëhet thirrje për agresion ushtarak apo për konflikt të armatosur, të nxitet dhe shpërhapet diskriminimi,

²⁸ Ligji për Ndalim të Dhunës dhe Sjelljes Jodinjitoze në Garat Sportive (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 89/2004; 142/2008; 135/2011; 27/2014)

²⁹ Ligji për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 89/2004; 142/2008; 135/2011; 27/2014. 50/2010; 127/2010; 44/2014; 150/2015)

³⁰ Ligji për Mediat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.184/2013 dhe 13/2014)

intoleranca dhe urrejtja në bazë të racës, gjinisë, fesë apo kombësisë. Në rast të shkeljes së këtij neni të ligjit, mund të dorëzoni ankesë te trupi kompetent rregullator, Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale të Mediave³¹, duke e treguar programin, median konkrete, datën dhe periudhën e emetimit të programit. Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale të Mediave, përkatësisht drejtori mund t'i marrë këto masa: të marrë vendim me të cilin do të paralajmërojë; të dorëzojë kërkesë për nisjen e procedurës për kundërvajtje në rastin kur edhe përkrah vendimit të marrë për paralajmërim vazhdon me kryerjen e të njëjtës shkelje për të cilën është paralajmëruar gjatë vitit; do të dorëzojë propozim te Këshilli për marrjen e lejes ose do të marrë vendim për heqje nga regjistri në përputhje me Ligjin për Shërbime Audio dhe Audiovizuale të Mediave³².

Për rastet e gjuhës së mediave në medime nga gazetarët të cilët janë anëtarë/anëtare të Shoqatës së gazetarëve të Maqedonisë mund të dorëzohet ankesë te Këshilli i Nderit³³ i Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë. Ky këshill i vendos dhe mbron parimet e gazetarisë etike, të balancuar dhe objektive e cila i respekton të drejtat e njeriut duke u ruajtur tërësisht lirinë e politikës redaktore të medias. Pas shqyrtimit të ankesës, nëse Këshilli i Nderit vërteton shkelje të parimeve dhe dispozitave të Kodeksit të Gazetarëve të Maqedonisë, ai reagon publikisht dhe e dënon shkeljen e tillë.

Për dallim nga Këshilli i Nderit i ShGM-së, që reagon ndaj shkeljes së kodeksit etik të gazetarëve, Këshilli i Etikës reagon për shkelje nga mediat dhe mediat duhet t'i pranojnë me patjetër dhe t'i shpallin vendimet e Këshillit.

Këshilli i Etikës në Media në Maqedoni funksionon si organizatë joqeveritare puna e të cilës ka për qëllim - rregullimin e mediave nëpërmjet zbatimit të sanksioneve morale ndaj të gjithë atyre që nuk i respektojnë standardet profesionale të Kodeksit³⁴ të Gazetarëve. Në suazat e Këshillit ekziston trup këshillëdhënës - Komisioni për Ankesat³⁵ i cili i shqyrton ankesat e qytetarëve, personave juridikë dhe përfaqësuesve të tjerë të opinionit në lidhje me përmbajtjet e shpallura në media, negocion midis personave që kanë dorëzuar ankesë dhe redaktorit, përkatësisht medias për përmbajtjen e të cilës është dorëzuar ankesë dhe merr vendime për ankesat në lidhje me shkeljet eventuale të Kodeksit. Ankesa mund të dorëzohet kundër një medie të caktuar, kurse ankesa anonime dhe ankesa kundër gazetarëve të veçantë nuk mund të dorëzohen.

Komisioni për Ankesa i shqyrton ankesat kundër mediave të cilat nuk janë anëtare të KEMM-it. Procedura edhe për këto ankesa është e njëjtë si ajo që zbatohet për Anëtarët e KEMM-së, me dallim se në vend të vendimit, Komisioni jep mendim për rastin. Vendimet dhe mendimet e veta, Komisioni për Ankesa i shpall në ueb-faqen e vet dhe dërgon lajmërim te të gjitha mediat, anëtare dhe jo anëtar të KEMM-së.

Në përputhje me atë që u tha më sipër konstatohet se Republika e Maqedonisë formalisht dhe juridikisht ka vendosur mekanizma juridikë dhe të pavarur për mbrojtje, megjithatë korniza ligjore mundëson interpretim shumë të gjerë të gjuhës së urrejtjes, duke e bërë kështu të pamundur implementimin e dispozitave penale. Siç është dhënë në kapitullin e fundit:

- sistemi gjyqësor nuk e njeh veprën pikërisht për arsyen se dispozitat janë përcaktuar gjerësisht dhe kërkojnë interpretim më preciz dhe njohje të fenomenit. Në kushte kur gjyqësori nuk i njeh

³¹ Ligji për Mediat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 184/2013 dhe 13/2014)

³² Ligji për Shërbime Audio dhe Audiovizuale të Mediave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 184/2013, 13/2014, 44/2014, 101/2014 dhe 132/2014).

³³ Rregullorja për përzgjedhje dhe punë të Këshillit të Nderit të ShGM-së, gjendet në: <http://www.znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/437>

³⁴ Kodeksi i Gazetarëve, gjendet në: <http://semm.mk/pravna-ramka/kodeks>

³⁵ Rregullorja e Këshillit për Ankesa në Këshillin e Etikës së Mediave në Maqedoni, gjendet në: <http://semm.mk/komisija-za-albi/delovnik>

dhe nuk i përdor praktikat e mira të rasteve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është pothuajse e pamundur të kryhet praktikë gjyqësore nacionale e cila në të ardhmen do të shërbente për përmirësim të qasjes të drejtat dhe drejtësia e viktimave të gjuhës së urrejtjes. Si shtesë, Mekanizmat e pavarur të cilët duhet të kenë kontroll mbi mediat shpesh kritikohen për anshmërinë e tyre, mosfunksionimin dhe mosinteresimin që të bëjnë përpjekje më të madhe për dënim të mediave të cilat nxisin dhe shpërhapin gjuhën e urrejtjes.

- Bashkëpunimi me sektorin OJQ mungon tërësisht, kurse me këtë vërtetohet politika e mosdënimit dhe injorimit të problemeve me të cilat ballafaqohen qytetarët nga organet kompetente.

3. SHEMBUJ TË GJUHËS SË URREJTJES NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Në praktikën e Maqedonisë te gjuha e urrejtjes dhe zbulimi dhe ndjekja e veprave të kryera nga urrejtja mungon qasja themelore e dallimit të tyre si formë e veçantë e krimit. Për fat të keq nuk ekziston as mbikëqyrje dhe informim i veçantë si dhe nuk ka statistika për këto vepra penale të kryera, nga shteti. Policia nuk ka evidenca të veçanta, madje edhe në vetë fletëparaqitjet penale nuk shënohet ekzistimi i motivit për urrejtje, edhe pse në raste të caktuara ekzistojnë indikacione të qarta se vetë kryerësi i këtyre veprave ka vepruar prej këtyre nxitjeve. Nga rezultatet e marra nga pyetësorët për mbledhje të informacioneve me karakter publik të marra nga gjykatat kompetente dhe prokuroritë publike themelore në Republikën e Maqedonisë, vërehet tendenca të anashkalohet apo t'u jepet një klasifikim i më i lehtë rasteve të nxitjes së urrejtjes, ndarjes apo intolerancës në bazë të nacionalitetit, racës, fesë apo bazë tjetër diskriminuese (neni 319 i KP-së). Për periudhën 2011 deri në 2014 ka vetëm një aktgjykim që ka hyrë në fuqi në territorin e Republikës së Maqedonisë për këtë vepër penale.

Shkaqet për moszbatimin e dispozitave ligjore janë të ndërlukuara dhe mund të lidhen me faktin se praktika gjyqësore ka qëndrim të rezervuar në lidhje me pranimin e konceptit të veprës së kryer nga urrejtja.

Një problem dhe shkak i veçantë për nxitjen e gjuhës së urrejtjes, madje dhe veprave nga urrejtja është ideologjia politike e etnonacionalizmit kur dominon politika. Ideologjia e tillë politike në mënyrë të hapur apo indirekte promovon glorifikim të kulturës së vet dhe shpërhapjen e paragjytimeve deri në demonizim të kulturave të tjera dhe etnokombësive që është bazë për shpërhapje të gjuhës së urrejtjes. Gjendja në Maqedoni vitet e fundit ka marrë dimensione të tilla në politikë dhe këtë e ka ndjekur zmadhimi intensiv i gjuhës së urrejtjes dhe veprave nga urrejtja.

Ekziston presion i vazhdueshëm mbi sistemin e drejtësisë ndëshkimore, ku përsëri shihet se gjyqësori nuk është i pavarur, kurse kështu zvogëlohen kapacitetet e tij për veprim objektiv, të pavarur dhe të paanshëm në lidhje me këto raste. Ndalimet juridike-ndëshkimore të gjuhës së urrejtjes fokusohen në inkriminimin e keqpërdorimit të lirisë së fjalës që përbëhen nga nxitja e dhunës.

Vendosja e konceptit përkatës ndëshkimor-juridik ndaj veprave dhe gjuhës së urrejtjes, si forma të krimit, është një prej kushteve themelore për vendosjen e shtetit demokratik juridik, i cili bazohet në parimin e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe barazisë së tyre, si dhe në të drejtën e tolerancës në një shoqëri pluraliste dhe multietnike. Ky koncept e përfaqëson kornizën juridike e cila është me rëndësi themelore për aktivitetet parandaluese dhe represive të shoqërisë për parandalim të diskriminimit, urrejtjes dhe paragjytimeve për grupe të marginalizuara dhe pakicash, të cilat mund të sjellin forma më intensive të mostolerancës dhe dhunës....

Në lidhje me mediat, Agjencia për Shërbimet Audio dhe Audiovizuale të Mediave është kompetente që të ndalojë përmbajtje programesh të cilat nxitin urrejtjen nacionale, racore apo

fetare dhe mostolerancën dhe t'u shqiptojë personave juridikë dhe redaktorëve përgjegjës gjopa në të holla për kundërvajtje që lidhet me emetimin e programeve të drejtuara kah nxitjes së urrejtjes nacionale, racore, gjinore dhe fetare. Në praktikën e deritanishme, edhe përkrah përmbajtjeve të shumta të emetuara apo të transmetuara, Agjencia nuk ka shqiptuar asnjë sanksion për kundërvajtje. Nga masat e tjera (paralajmërim me shkrim, ndalim i përkohshëm etj.) të parapara në kodeksin e përmendur, Agjencia (më parë Këshilli i Radiodifuzionit) ka shqiptuar vetëm dy: “paralajmërim joformale” (TV Sitell dhe RTM) dhe një ndalim për emetim të reklamës në afat prej dy ditësh (Kanal 5 për gjuhën e urrejtjes në emisionin “Milenko Nedelkovski Shou”).

Në praktikën maqedonase të organeve kompetente për parandalim dhe ndalim të gjuhës së urrejtjes, ekziston raport injorues ndaj zbatimit të këtyre ndalime ligjore, kurse kjo dëshmohet nga numri i vogël i rasteve të regjistruara të cilat ndiqen penalisht. Për shkak të këtij fakti, edhe pse kemi në dispozicion statistika gjyqësore për periudhën nga viti 2011 deri në vitin 2014, të cilat dëshmojnë se është shumë i vogël numri i procedurave gjyqësore të ngritura, por prej tyre nuk mund të arrijmë të përfundimi real mbi madhësinë dhe shpërhapjen e këtij problemi shoqëror, i cili përsëri mbahet në kushte të shkallës së lartë të tensioneve politike dhe ndërretnike.³⁶

Si rezultat i kësaj vitet e fundit gjithnjë dhe më tepër mund të vihet re thirrja për konflikte ndërretnike në garat sportive, djegia e flamujve, thirrje nëpërmjet rrjeteve sociale për kundërvënje të dhunshme ndaj aksioneve të organeve shtetërore. Reagimi i gjykatave ndaj këtyre sjelljeve është shumë i lehtë, shpesh me mbulim mediatik të evenimentit inkriminues, kurse aludohet se ai eveniment është vetëm një incident i izoluar i cili nuk duhet të merret për praktikë në shoqëri.

Për sjelljet e tilla, me të cilat nxitet urrejtja dhe dhuna, e bazuar mbi racën, nacionalitetin apo përkatësinë fetare, Ligji për Parandalim të Dhunës dhe Sjelljes Jopërkatëse në Garat Sportive në nenin 13 dhe 14 i jap shkeljet, megjithatë në praktikë nuk kemi ose përsëri janë shumë të rralla rastet kur është zbatuar ngritje e procedurës së kundërvajtjes kundër kryerësve të veprave.

Në legjislacionin ndëshkues maqedonas koncepti i veprës së kryer prej urrejtjes filloi të zbatohet pas ndryshimeve të reja të KP-së të vitit 2009, me të cilat zbatohet dispozita e përgjithshme për njehsimin e dënimit (neni 39, pika 5), dispozitë me të cilën si rrethanë vështirësuese gjatë njehsimit të dënimit për çdo vepër penale të kryer, gjykata duhet të ketë parasysh kryerjen e veprës kundër një personi apo prone në bazë të ndonjë prej bazave të mbrojtura. Kryerja e veprës ndëshkuese, pavarësisht se cila, në bazë të tillë diskriminuese, duhet të jetë rrethanë vështirësuese gjatë njehsimit të dënimit, përkatësisht gjatë vlerësimit të kësaj rrethane dënimi i cili do të jepet duhet të jetë përafërsisht me maksimumin dhe jo me minimumin e dënimit.


Duke pasur parasysh statistikën gjyqësore për raste me këto baza, është më se e qartë se vepra nuk njihet ose injorohet duke e bërë të pamundur praktikën gjyqësore si bazë për përparimin e të drejtës në këtë drejtim.

Në përputhje me të dhënat e mbledhura nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut nga platforma për shënim të gjuhës së urrejtjes në kohë reale (www.govornaomraza.mk) dhe për dallim nga mungesa e praktikës gjyqësore, është më se e qartë se në Republikën e Maqedonisë gjuha e urrejtjes si fenomen përfaqësohet theksueshëm sidomos në bazë të përkatësisë etnike dhe orientimit seksual.

³⁶ Analiza e të dhënave prej pyetësorëve të mbledhur nga të gjitha instancat gjyqësore, Prokuroria Publike dhe Ministria e Punëve të Brendshme, të dorëzuara në formatin e kërkesës së informacioneve me interes publik në përputhje me Ligjin për Qasje të Informacionet me Interes Publik.

Procesi i dokumentimit/shënimit të gjuhës së urrejtjes në platformën interaktive në ueb zyrtarisht ka filluar në prill të vitit 2014 deri në fund të muajit korrik 2015, periudhë në të cilën janë mbledhur 237 fletëparaqitje gjithsej, prej të cilave 103 janë vërtetuar, kurse 90 fletëparaqitje janë verifikuar. Dallimi prej 13 fletëparaqitjesh të vërtetuara lidhet me fletëparaqitjet ku është dhënë se ekziston bazë për gjuhë të urrejtjes, por për shkak të mungesës së informacioneve nëpërmjet të cilave mund ta verifikohet kjo gjë ato shënohen si kategori e veçantë e cila nuk ndikon mbi rezultatin përfundimtar të statistikës së nxjerrë. Pjesa më e madhe e fletëparaqitjeve të platformës janë dorëzuar nga 20 vullnetarë të shpërndarë që t'i përfshijë të tetë rajonet joadministrative³⁷. Të dhënat e nxjerra nga platforma dëshmojnë mbi faktin se gjuha e urrejtjes është e pranishme në të gjitha rajonet, kurse në pjesën më të madhe është e pranishme në rrjetet sociale dhe mediat e bazuara në internet. Për shkak të natyrës së fenomenit, vullnetarët kanë vërejtur gjuhë të urrejtjes në hapësirën publike në nivel lokal dhe qendror nëpërmjet grafitëve të dokumentuar. (Shiko grafikun 1.)

Të dhënat statistikore të kategorive të cilat janë paraqitur në platformë në përputhje me Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë dëshmojnë se:




Grafiku 1: baza, fletëparaqitje dhe përfaqësimi në përqindje

* Si baza të tjera të gjuhës së urrejtjes mund të konsiderohen: përkatësia politike, prejardhja sociale, gjendja familjare/martësore, statusi shoqëror dhe pronësor. Edhe pse sipas standardeve ndërkombëtare, këto baza nuk janë kategori e pandryshueshme e mbrojtur, autorët e analizës, duke pasur parasysh rrethanat shoqërore në shtet, e konsiderojnë si të dobishme t'i marrin parasysh dhe t'i analizojnë rastet e paraqitura për këto baza.

- Numri më i madh i fletëparaqitjeve lidhet me kategorinë e vendosur si gjuhë e urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike/përkatësisë fetare/gjuhës/kombësisë.
- Si kategori e dytë me numër më të madh të fletëparaqitjeve është gjuha e urrejtjes në bazë të seksit/gjinisë/orientimit seksual dhe identitetit gjinor.
- Numri më i madh i fletëparaqitjeve është dorëzuar për më tepër baza dhe shpesh në fletëparaqitjet për tekst të botuar, koment apo përmbajtje tjetër në rrjetet sociale dhe mediat mund të hasen më tepër baza të gjuhës së urrejtjes. Përkatësisht shumica e fletëparaqitjeve ishte për dy apo më tepër baza njëkohësisht, dhe këto në bazë të orientimit seksual dhe përkatësisë etnike.

³⁷ Me rajone joadministrative nënkuptohet ndarja territoriale e Republikës së Maqedonisë në rajonin e: Pologut, Pellagonisë, Shkupit, Vardarit, Jugverior, Jugperëndimor, Lindor dhe Juglindor.

- Grafiku i cili në përputhje me fletëparaqitjet i mat parametrat për eskalim të gjuhës së urrejtjes vërteton se kjo dukuri lidhet ngushtë me programet politike të cilat përmbajnë diskurse nacionaliste, kurse ndikojnë mbi trupin votues. Si shembuj dhe në përputhje me raportet mujore të Komitetit, gjuha e urrejtjes ka eskaluar më shumë gjatë zgjedhjeve të parakohshme parlamentare dhe zgjedhjeve të rregullta presidenciale. Pastaj, gjatë periudhës paszgjedhore ose pas shpalljes së aktgjykimit për të akuzuarit në rastin “Liqeni i Smilkovës”:
- Shqetëson veçanërisht fushata aktive për zmadhimin e homofobisë nëpërmjet promovimit të të a.q. vlerave tradicionale nga pushteti ekzekutiv. Kjo fushatë padyshim që rezulton me zmadhim të numrit të fletëparaqitjeve në platformë në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Fushata e tillë përveç gjuhës së urrejtjes rezulton edhe me një sulm mbi bashkësinë LGBTI gjatë një evenimenti publik. (Shiko grafikun 2).³⁸



Grafiku 2: Zmadhimi i gjuhës së urrejtjes në intervale të caktuara kohore sipas muajve

- Gjuha e urrejtjes stimulohet në mënyrë indirekte nga pushtetit ekzekutiv, shpesh nëpërmjet mediave proqeveritare kur kryhet etiketim i individëve apo grupeve të cilët janë pjesë e lëvizjeve qytetare, iniciativave formale dhe joformale në rrjetet sociale dhe media. Numri i grafitëve të cilët kanë gjuhë të urrejtjes, gjithashtu, lidhet me ngjarjet aktuale shoqërore-politike. Shqetëson fakti se pjesa më e madhe e këtyre grafitëve u drejtohen përfaqësuesve të grupeve etnike dhe të marginalizuara. Por, gjithashtu, është vënë re rritje e grafitëve të cilët përmbajnë simbole naziste që lidhen me retorikën e theksuar nacionaliste dhe propagandën e cila vjen nga pushteti ekzekutiv.

Komiteti i Helsinkit reagon rregullisht mbi trendet e rritjes së gjuhës dhe veprave nga urrejtja në Republikën e Maqedonisë nëpërmjet ndjekjes së gjuhës së urrejtjes në kohë reale, informimit të opinionit për të dhënat nëpërmjet raporteve mujore dhe vjetore dhe dorëzimin e fletëparaqitjeve penale përkatëse. Sidomos shqetëson fakti që institucionet kompetente siç janë Prokuroria Publike dhe Njësia për Krim elektronik në Ministrinë e Punëve të Brendshme nuk ndërmarrin rol proaktiv në zvogëlimi apo ndalimin e gjuhës së urrejtjes.³⁹ Gjithashtu shqetësojnë të dhënat se edhe përkrah

³⁸ Raporti dymujor mbi gjendjen e të drejtave të njeriut i KHM-së: http://www.mhc.org.mk/system/uploads/redactor_assets/documents/861/Dvomesecen_iz-vestaj_noemvri_dekemvri_2014.pdf стр. 4.

³⁹ Për shkak të zmadhimit të gjuhës së urrejtjes ndaj bashkësisë dhe aktivistëve të shquar për të drejtat e LGBTI sidomos në rrjetin social Fejsbuk, Komiteti i Helsinkit ka dorëzuar kërkesa për gjetjen e kryerësve në Njësinë për Krim Elektronik në MPB, por deri më tani nuk kemi marrë asnjë përgjigje për asnjë kërkesë.

pranisë gjithnjë dhe më të madhe të gjuhës së urrejtjes dhe reflektimit të saj në një numër të madh veprash dhe incidentesh të kryera prej urrejtjes kjo nuk i motivon institucionet kompetente ta analizojnë dhe ta sanksionojnë si duhet këtë dukuri. Komiteti i Helsinkit, së bashku me Koalicionin për të Drejta Seksuale dhe Shëndetësore të Grupeve të Margjinalizuara të Prokuroria Publike ka dorëzuar 3 fletëparaqitje penale për shpërhapje të gjuhës së urrejtjes ndaj personave të LGBTI-së, dy prej këtyre fletëparaqitjeve ishin dorëzuar pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Procedurë Penale. Për fletëparaqitjen e parë e cila është dorëzuar para 2,5 vitesh në përputhje me dispozitat e ligjit të vjetër për procedurë penale, ende nuk kemi marrë përgjigje, kurse për 2 fletëparaqitjet e tjera kemi marrë përgjigje negative nga PThP Shkup, ku thuhet se veprat penale të paraqitura nuk janë vepra që ndiqen me obligim zyrtar. Për zgjidhjet e tilla është dërguar ankimum në PLP Shkup e cila vendosi që për njërin rast ta vërtetojë qëndrimin se rasti konkret nuk është vepër e cila ndiqet me obligim zyrtar, sepse nuk ka elementë të gjuhës së urrejtjes, kurse për rastin e dytë vendosi se PThP Shkup nuk e hetuar tërësisht rastin, prandaj ekzistojnë elementë të gjuhës së urrejtjes dhe lënda është kthyer për ripërsëritje të procedurës në PThP Shkup. Qëndrimi i tillë i PLP-së është precedent, sepse në praktikën e deritanishme del se për fletëparaqitjet penale për gjuhën e urrejtjes ose nuk veprohet ose hidhen poshtë pa u zbatuar hetim i tërësishtëm dhe serioz. Megjithatë, qëndrimi i tillë i prokurorit të PLP Shkup tani për tani është rast i izoluar, i cili duhet të ndiqet edhe nga prokurorët e tjerë publikë të cilët veprojnë për fletëparaqitje për gjuhë të urrejtjes. Përkrah mbrojtjes gjyqësore, pushtetet lokale nuk ndërmarrin masa në kohë për heqjen e grafitë me gjuhë të urrejtjes, edhe pse si mbartës të funksioneve publike ekzekutive kanë obligim të ndalojnë shpërhapjen e urrejtjes. Heshtja e përgjithshme e të gjitha institucioneve relevante për këtë fenomen, mund të kuptohet edhe si miratim për kryerësit, të cilët nëse nuk ballafaqohen me veprën e kryer mund ta përsëritin apo të kryejnë krim prej urrejtjes në varësi nga baza ndaj të cilës kanë qëndrim subjektiv dhe urrejtje.

Në përputhje me atë që është thënë më sipër dhe nga analiza e të dhënave të mbledhura përgjigjet e dy tezave të vendosura me interes për hulumtimin dëshmojnë se:

1. Republika e Maqedonisë ka kornizë precize, të saktë dhe të definuar ligjore për gjuhën e urrejtjes.

Korniza juridike momentale ka nevojë për përcaktim më të qartë të gjuhës së urrejtjes si vepër penale. Kodi Penal pjesërisht gabueshëm (me listë të hapur të karakteristikave për mbrojtje), e përcakton gjuhën e urrejtjes duke e dobësuar efikasitetin e luftës kundër tij. Komiteti i Helsinki vlerësoi se me ndarjen dhe përcaktimin më të qartë të fenomeneve do të mundësohet praktikë më e mirë gjyqësore dhe qasje të drejtësia për viktimat e gjuhës së urrejtjes. Kështu do të mundësohet qasje më e lehtë të informacionet e gjykatësve të cilët i procesojnë këto vepra si edhe të përfaqësuesit juridikë të viktimave. Për shkak të mungesës së praktikës gjyqësore, gjykatat duhet t'u kushtojnë vëmendjen e duhur vendimeve gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut sepse Republika e Maqedonisë ka marrë obligimin ta respektojë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe është anëtare me të drejta të plota e Këshillit të Evropës.

2. Qytetarët kanë qasje të mekanizmat efektivë dhe efikasë për mbrojtje nga gjuha e urrejtjes

Duke pasur parasysh se në përputhje me të dhënat statistikore të marra nga instancat gjyqësore në territorin e Republikës së Maqedonisë në periudhë prej 3 vjetësh është shqiptuar vetëm një aktgjykim, mungesën e të dhënave statistikore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, vëmendjen e obligueshme për përmbajtjet e mediave dhe qasjen objektive në politikat ndëshkimore të Agjencisë

për Shërbime Audio dhe Audiovizuale të Mediave, konstatohet se qytetarët nuk kanë mekanizma efikasë dhe efektive për mbrojtje nga gjuha e urrejtjes. Është më se e qartë se Prokuroria Publike nuk ndërmerr procedura ndaj personave të diskursit publik të cilët shpesh flasin me gjuhën e urrejtjes, kurse shpesh nuk vepron as për fletëparaqitjet penale të dorëzuara për gjuhë të urrejtjes, që dëshmon se ekziston mjet joefikas dhe joefektiv juridik. Domethënë, prokurori publik ka për detyrë të ngrejë procedura dhe vetëm me dëgjim të fjalës, por në dy vitet e kaluara ai nuk e ka shfrytëzuar këtë mundësi. Shtesë, për fletëparaqitjet penale të dorëzuara nuk ka dhënë mendim me çka e ka kufizuar qasjen te drejtësia të viktimës nga gjuha e urrejtjes. Nga kjo mund të nxirret përfundimi se nevojiten ndryshime thelbësore dhe sistematike në qasjen te mekanizmat efikasë dhe efektive për mbrojtje nga gjuha e urrejtjes, me qëllim të mbrojtjes së të drejtës së barabartë dhe trajtimit të barabartë të qytetarëve në qasjen te drejtësia, kurse përfundimi i cili del nga kjo është se Maqedonia ka efektivitet mjaft të dobët të qasjes te mekanizmat për mbrojtje nga gjuha e urrejtjes.

PËRFUNDIME:

1. Korniza formale-juridike për njohjen dhe sanksionimin e gjuhës së urrejtjes është e pasaktë dhe pamundëson kornizë të qartë për përcaktimin dhe përfshirjen e gjuhës së urrejtjes duke mos krijuar kështu kushte për praktikën gjyqësore.
2. Mekanizmat e pavarur për mbrojtjen e gjuhës së urrejtjes në media nuk e njohin gjuhën e urrejtjes dhe nuk i sanksionojnë kryerësit.
3. Gjuha e urrejtjes e transmetuar apo e nxitur në rrugë elektronike shënon rritje të lartë në dy vitet e fundit, kurse niveli i sanksionimit të kryerësve që është në kompetencë të Ministrisë së Punëve të Brendshme (Njësia për Krim Elektronik) mbetet pas.
4. Mekanizmat e pavarur dhe të jashtëm për mbrojtjen nga gjuha e urrejtjes në media nuk u kushtojnë vëmendje të veçantë standardeve etnike dhe profesionale në gazetari, edhe pse mediat jo rrallë janë gjeneratorë të trendeve negative në gjuhën e urrejtjes.
5. Ministria e Punëve të Brendshme nuk posedon të dhëna statistikore për gjuhën e urrejtjes.
6. Prokuroria Publike në raste të gjuhës së urrejtjes nuk vepron sipas obligimit zyrtar, dhe nuk tregon interes për veprim përkatës dhe në kohë për fletëparaqitjet penale të dorëzuara.
7. Ministria e Arsimit dhe Shkencës nuk ka parashikuar programe për ngritjen e vetëdijes tek të rinjtë për gjuhën e urrejtjes si fenomen shoqëror.
8. Nivel i pamjaftueshëm i trajnimit për njohjen dhe sanksionimin e gjuhës së urrejtjes për nëpunësit policorë, gjykatësit, prokurorët publikë dhe avokatët dhe trajnimet e zbatuara nga organet relevante.
9. Kodi penal nuk parashikon mjete alternative apo sanksionime për kryerësit e gjuhës së urrejtjes.
10. Mungojnë fushata publike për njohjen dhe parandalimin e gjuhës së urrejtjes në hapësirën publike kështu që vetëdija për këtë fenomen te qytetarët është mjaft e ulët.

REKOMANDIME

1. Republika e Maqedonisë ka një kornizë formale të dobët për njohjen dhe sanksionimin e gjuhës së urrejtjes. Praktika gjyqësore dhe parimi i mosdënimit dëshmojnë për nevojën për kodifikim dhe përcaktim më të qartë të neneve në Kodin Penal të cilat e përfshijnë këtë vepër. Duke pasur parasysh se orientimi seksual si bazë nuk është përcaktuar, kurse sipas të dhënave statistikore është baza e dytë e urrejtjes në shtet, duhet të vendoset në mënyrë eksplicite.

2. Mekanizmat e pavarur për mbrojtjen nga gjuha e urrejtjes në media, siç është Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale të Mediave, t'i zbatojnë kompetencat e veta, njëkohësisht të marrin rol proaktiv në gjykimin e gjuhës së urrejtjes në diskursin publik.

3. Ministria e Punëve të Brendshme dhe Njësia për Krim Elektronik të marrin rol proaktiv në shkatërrimin e gjuhës së urrejtjes të transmetuar dhe të nxitur në rrugë elektronike. Njëkohësisht të vendosin bashkëpunim më të mirë me pushtetet lokale dhe t'u rikujtojnë kompetencat për heqje të gjuhës së urrejtjes nga sipërfaqet publike.

4. Ministria e Punëve të Brendshme të fillojë të mbajë statistika të të dhënave për bazat e gjuhës dhe krimit prej urrejtjes në përputhje me rekomandimet e Misionit të OSBE-së të cilat në 3 vitet e fundit kanë dorëzuar kërkesë në raportet për përparim të demokracisë dhe të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë si anëtare e barabartë në këtë organizatë.

5. Prokuroria Publike ta zmadhojë interesin dhe të veprojë sipas obligimit zyrtar dhe fletëparaqitjeve penale të dorëzuara për gjuhë të urrejtjes në përputhje me kompetencat.

6. Përpunimi dhe vendosja e programeve kundër gjuhës së urrejtjes në shkollat e mesme dhe tetëvjeçare në Republikën e Maqedonisë dhe puna e zmadhuar me të rinjtë në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës me organizatat joqeveritare të cilat punojnë në këtë tematikë.

7. Zbatimi i trajnimeve për nëpunësit policorë, gjykatësit, prokurorët publikë dhe avokatët me qëllim ngritje të vetëdijes, njohjen dhe kuptimin e fenomenit të gjuhës së urrejtjes, duke përfshirë edhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në këtë fushë.

8. Dispozitat ndëshkimore në Kodin Penal duhet të ofrojnë edhe masa alternative për dënimin e kryerësit. Shembujt praktikë për punë vullnetare në organizatat joqeveritare me kryerësit në përputhje me bazën e urrejtjes ndaj individit apo grupit japin rezultate më të mëdha në procesin e riintegritimit dhe rehabilitimit të kryerësve përveç dënimit të shqiptuar me burg apo në të holla.

9. Nevojitet angazhim më i madh nga pushteti ekzekutiv në promovimin e vlerave si barazi, njëtrajtshmëri dhe tolerancë të dallimeve dhe përmbajtjes edukative për publikun gjatë njohjes së gjuhës së urrejtjes.

10. Mediat dhe gazetarët duhet të kenë mekanizma rigorozë për kontroll dhe heqje të gjuhës së urrejtjes në informacionet të cilat i japin. Kurse mediat dhe gazetarët të cilët nxitin apo shpërhapin gjuhën e urrejtjes duhet të sanksionohen në përputhje me Kodin Penal. Shoqatat e qytetarëve, Këshilli i Etikës së Mediave dhe sindikatat e gazetarëve të marrin rolin udhëheqës në vendosjen e standardeve të larta etike dhe morale në shkrimin dhe informimin e publikut.

Literatura e përdorur:

1. Weber Anne, "Manual on hate speech", Council of Europe, 2009
2. Mihajlova Elena, dr. Bačovska Jasna, mr. Sheqerxhiev Tome "Liria e fjalës dhe gjuha e urrejtjes", OSBE, Shkup, 2013
3. "Homophobia and Discrimination on Grounds of Sexual Orientation in the EU Member States Part I – Legal Analysis" (European Union Agency for Fundamental Rights), June 2008
4. Mihajlova Elena, "Govorot na omraza i kulturnite razliki", Templlum, Shkup, 2010
5. Raporti dymujor (nëntor-dhjetor) mbi gjendjen e të drejtave të njeriut i Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë, 2014

Ligje dhe akte të tjera:

1. Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 37/1996; 80/1999; 4/2002; 43/2003; 19/2004; 81/2005; 60/2006; 73/2006; 7/2008; 139/2008; 114/2009; 51/2011; 135/2011; 185/2011; 142/2012; 166/2012; 55/2013; 82/2013; 14/2014; 27/2014; 28/2014; 41/2014; 41/2014; 115/2014; 132/2014; 160/2014
2. Ligji për Parandalim të Dhunës dhe Sjelljes Jopërkatese në Garat Sportive (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 89/2004; 142/2008; 135/2011; 27/2014)
3. Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 50/2010; 127/2010; 44/2014; 150/2015)
4. Ligji për Mediat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 184/2013 dhe 13/2014)
5. Ligji për Mediat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 184/2013 dhe 13/2014)
6. Ligji për Shërbimet Audio dhe Audiovizuale të Mediave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 184/2013, 13/2014, 44/2014, 101/2014 dhe 132/2014).
7. Rregullorja për zgjedhjen dhe për punën e Këshillit të Nderit të ShGM-së
8. Kodeksi i Gazetarëve
9. Rregullorja e Punës e Komisionit për Ankesa në Këshillin për Etikë në Mediat në Maqedoni

Marrëveshje ndërkombëtare:

1. Marrëveshja për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, 2007
2. Direktiva 2000/43/KE e Këshillit të BE-së për implementim të parimeve për trajtim të barabartë të njerëzve pavarësisht nga prejardhja e tyre etnike dhe raca e tyre, 2000

Link:

1. www.govornaomraza.mk
2. <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:12012E/TXT>
3. <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:32000L0043:en:HTML>
4. <http://www.znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/437>
5. <http://semm.mk/pravna-ramka/kodeks>
6. <http://semm.mk/komisija-za-albi/delovnik>
7. http://www.mhc.org.mk/system/uploads/redactor_assets/documents/861/Dvomesecen_izvestaj_noemvri_dekemvri_2014.pdf стр. 4